



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

KKDM/Nr.⁵..... Prot
Lutemi referoni këtë numër në përgjaje

Tiranë, më 17/01 / 2022

VENDIM
Nr.02, date 17 /01/2022

PËR

**VLERESIMIN E MONITORIMIT TE FENOMENEVE GJEODINAMIKE TE DIGAVE
TE UJITJES**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 8681, datë 02.11.2000 "Për Projektimin, Ndertimin, Shfrytëzimin dhe Mirembajtjen e Digave dhe Dambave" dhe VKM Nr. 147, datë 18.03.2004 "Miratimin e Rregullores për Sigurinë e Digave dhe të Dambave", Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha (KKDM) në mbledhjen e datës 17.01.2022 mori në shqyrtim Vlerësimin e Monitorimit të fenomeneve gjeodinamike të digave të ujitjes të kryer nga Sherbimi Gjeologjik Shqiptar. Në këtë Vlerësim I cili ka filluar në vitin 2015 janë përfshirë deri tani afro 458 diga të mëdha dhe të vogla që përdoren për ujitje në vendin tone. Bazuar në dokumentacionin teknik të paraqitur, dhe Rezultateve të monitorimit të fenomeneve gjeodinamike vihet re se është kryer një vlerësim paraprak i këtyre fenomeneve duke u bazuar në Inspektime vizuale të ekspertëve në terren si dhe në disa raste përmes përdorimit të metodave gjeofizike. Antaret e KKDM vlerësuan punën e kryer dhe u shprehën se rezultatet e këtij vlerësimi mund të shërbejnë si vlerësime paraprake për studime dhe analiza më të hollësishme dhe më të thelluara për digat me probleme gjeoteknike dhe gjeologjike. Pas diskutimeve të të gjithë antareve të pranishëm, KKDM

VENDOSI:

1- Ti kërkojë Sherbimit Gjeologjik Shqiptar (SHGJSH)

- Te informoj zyrtarisht KKDM, brenda muajit Shkurt 2022 për Digat e Ujitjes të investuara dhe të monitoruara gjatë vitit 2021 që janë vlerësuar si problematike në lidhje me fenomenet gjeoteknike dhe gjeologjike të tyre duke përfshirë edhe rreshqitjet në trupin e këtyre digave. Raporti duhet të përfshijë në mënyrë të detajuar Rezultatet konkrete, për zonat me rreshqitje ose fenomene të tjera negative që janë vërejtur gjatë vizitave në terren.
- Vazhdimin e Vlerësimit të fenomeneve gjeodinamike në digat e Ujitjes duke i dhënë përparësi digave të mëdha të dhena në Rregjistrin Kombëtar të aprovuar nga KKDM si dhe digave me rrezik të mundshëm për humbje njerëzish në raste të prishjes së tyre. Në këtë vlerësim duhet të përfshihen edhe analiza e fenomeneve të sedimentimit në ujembledhesat e krijuar nga këto diga
- Te informojë zyrtarisht KKDM, brenda muajit Shkurt 2022 për Digat e Ujitjes që do të merren në shqyrtim dhe do të monitorohen nga ekspertet e SHGJSH
- Te bashkëpunojë me KKDM dhe shfrytëzuesit e digave të Ujitjes gjatë procesit të monitorimit dhe Investigimit të digave të marra në shqyrtim sipas një programi të detajuar



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

- 2- Ti kërkojë Shfrytëzuesve të Digave të Lavdarit në bashkinë Korce dhe Zall Herrit në bashkinë Tiranë të hartojnë projekte të detajuara për marrjen e masave përkatëse për Rehabilitimin e Digave të mesiperme. Projektet duhet të përgatiten në përputhje me VKM Nr. 147, datë 18.03.2004 "Miratimin e Rregullores për Sigurinë e Digave dhe të Dambave", Neni 9 dhe Neni 27. Këto projekte duhet të miratohen në KKDM për zbatimin të tyre në terren

Ngarkohet Sekretariati Kombëtar i Digave të mëdha (SKDM) si zyrë ekzekutive e KKDM për ndjekjen dhe zbatimin e masave të kërkuara në këtë Vendim sipas legjislacionin në fuqi.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë

KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

KRYETARI

Arjan JOVANI

